



Npi – 01/88 datë: 14.05.2020

Duke u bazuar në nenin 40.2 pikat (b dhe c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Nenin 58.3 të Ligjit, për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-48 të ndryshuar dhe plotsuar me Ligjin Nr.03/L-221; Si dhe në bazë të nenit 2.3 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049; Kuvendi i Komunës së Shtimes pasi analizoi propozimin e Zyrës Kryesore Financiare në mbledhjen e mbajtur më 14.05.2020, aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR APROVIMIN E NDARJES SË TË HYRAVE TË BARTURA NGA VITI 2019 NË VITIN 2020

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -III- të rregullt për vitin 2020, të mbajtur më: 14.05.2020, me shumicën e votave aprovoi Vendimin për ndarjen e të hyrave vetanake të bartura nga viti 2019, në vitin 2020, sipas kësaj tablele:

Nr.	Kodi i OB	Kodi Ekonomik	Kodi i propozuar i programit për vitin 2019	Kodi i projektit në vitin 2020	Programi Buxhetor	Emërtimi i projektit	Ndryshimi i propozuar për vitin 2020 në €
1	617	30	660(66340)	45315	Planifikim Urban, Mjedisi dhe Inspeksion	Projektet e infrastruktures me participim	22,223.10€
2		30	660(66340)	45210	Planifikim Urban, Mjedisi dhe Inspeksion	Pagesat për shpronsime	33,692.19
3		30	660(66340)	47033	Planifikim Urban, Mjedisi dhe Inspeksion	Asfaltimi dhe kanalizimi i rrugëve Belinc	7,276.80€
4		30	755(75532)	45721	Sherbimet Rezidenciale	Ndërtimi i Ojektivit të Shtëpisë së Komunitetit SHKSH në Shtime	19,025.30€
5		13	163(16307)		Administrat dhe Personel	Mallra dhe Sherbime	25,615.93€
6		13	920(93180)		Arsimi Fillor	Mallra dhe Sherbime	25,000.00€
7		13	920(92330)		Arsimi Parashkollor Qerdhja	Mallra dhe Sherbime	1,500.00€
8		13	755(75531)		Sherbimet Sociale	Mallra dhe Sherbime	10,000.00€

9		13	730 (73450)		Shendetsia Primare	Mallra dhe Sherbime	31,319.06€
10		13	166 (16613)		Inspekcioni	Mallra dhe Sherbime	21,000.80€
11		20	730(73016)		Administrata	Subvencione dhe Transfere	6,144.68€
12		20	470(47047)		Zhvillimi dhe Inspektimi Bujqësor	Subvencione dhe Transfere	10,000.00€
13		11	730 (73450)		Shendetsia Primare	Paga dhe Mëditje	19,222.65€
						Gjithsej	232,020.51€

II

A r s y e t i m:

- Propozimet – me numër rendor 1 deri 4 janë në kategorin e Shpenzimeve Kapitale dhe për përmbushjen e kontratave dhe obligimeve në projektet e planifikuara për realizim në këtë periudhë dhe sipas drejtorisë ku janë planifikuar ato projekte. Gjithashtu në kuadër të projektit, Projektet e infrastrukturës me participim do të implementohet projekti, sipas Vendimit të Kuvendit Komunal, Npi-01/358 datë 26.11.2019, “Kanalizimi i ujërave të zeza për Lagjen Ademaj – fshati Petrovë”.
- Propozimet - me numër rendor nga 5 deri ne 10 jane në kategorin Mallra e Shërbime sipas programeve buxhetore: Adinistratë e Përgjithshme, për mbulimin e aktiviteteve të planifikuara, Drejtoria e Shërbimeve Publike - Inspektimet për mbylljen e kontratës për mirmbajtjen dimrore të rrugëve, Arsimi, për mbulimin e aktiviteteve të planifikuara, Shendetsi Primare për përmbushjen e kulmit nga participimet në Shendetsi, si dhe për ushqim-Qerdhja.
- Propozimi – me numër rendor 11 dhe 12 janë në kategorinë Subvencione dhe Transfere sipas programeve buxhetore : Administrata Shëndetsi ka të bëjë me përmbushjen e kulmit në Subvencione , Bujqesi ndihme per fermerëve per shkak te gjendjes se krijuar nga Pandemia.
- Propozimi me numër 13 ka të bëjë me realizimin e të hyarve nga participimi në shëndetësi dhe të cilat nuk janë shpenzuar në vitin 2019 dhe bartën në vitin 2020 në kategorin Paga dhe Mëditje e që mbulohen pagesat e Kujdestarisë në shëndetësi.
- Këto ndarje jane bërë sipas gjendjes se krijuar me Pandemin COVID-19 ku nje pjesë e mjeteve është marr nga këto programe dhe jane përdorur per mbulimin e kërkesave emërgjente te Shtabit Komunal të Emërgjences e qe kane pasur per qellim parandalimin e perhapjes të Infektimit te qytetareve me virusin COVID-19.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Zyrës për Financa, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, Ministrisë të Financave dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj